



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilimje/Prodato Received/Delivery	24.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSTRK	6426/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.743/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.743/2022 të datës 29.08.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Prizrenit të datës 27.07.2022, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa A.nr.743/2022 e datës 29.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **SHFUQIZOHET** Vërejtja me shkrim e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Prizrenit e datës 27.07.2022.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Prizrenit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



Arsy e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Komunën e Prizrenit, me datë 26.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me datë 29.08.2022 dhe numër protkoli:5010/2022, kundër masës disiplinore- vërejtje me shkrim të shqiptuar me datë 27.07.2022 nga Kryetari i Komunës së Prizrenit.

Ankuesi, me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill, pretendon se vërejtja me shkrim apo masa e shqiptuar disiplinore nga Kryetari i Komunës së Prizrenit e datës 27.07.2022, është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit material dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i pavarur mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Prizrenit me datë 06.09.2022. Këshilli, me datë 15.09.2022 me numër protokollit 5413/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, sipas kërkesë së Kryetarit të Kolegjit me datë 11.10.2022 ka nxjerrë vendimin VK.nr.113/2022 përmes të cilit ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për 10 (dhjetë)ditë pune, ankesës së ankuesit me shifër A.nr.743/2022 të datës 29.08.2022 për shkak të specifikave të lëndës dhe nevojës për shqyrtime shtesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5010/2022 të datës 29.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga drejtuar Ankesa KPMSHCK e datës 26.08.2022; E-mail nga drejtuar e datës 24.08.2022; Kërkesë për përgjigje në vërejtjen me shkrim nga Menaxheri i NJBNJ drejtuar Kryetarit të Komunës 1-8 faqe; E-mail nga drejtuar KK Prizren Punëtorët, KK Prizren Drejtorët e datës 16.06.2022; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me umer të protokollit.1732/2022 e datës 30.03.2022 me shkresën e bashkëngjitur të raportit të monitorimit; E-mail nga I.G për Sh.T e datës 22.07.2022; Shkresë " Pjese e shkëputur nga raporti i auditorit te përgjithshëm" 1-3 faqe; E-mail nga I.G drejtuar Sh.T e datës 17.12.2021 me korrespondencën e bashkëngjitur prej 1-4 faqe; Udhëzimi administrativ(MAPL) nr.01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna; E-mail nga Sh.T drejtuar I.G e datës 22.08.2022 me korrespondencën e bashkëngjitur prej 1-3 faqe; E-mail nga I.G drejtuar Sh.T e datës 25.08.2022 me korrespondencat e bashkëngjitura prej 1-8 faqe; E-mail nga Sh.T drejtuar I.G e datës 27.07.2022; Vërejtje me shkrim lëshuar nga Kryetari i Komunës së Prizrenit për I.G e datës 27.07.2022; Shkresë "Të gjeturat dhe rekomandimet e zyrës kombëtare të auditimit për komponentin e burimeve njerëzore për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 prej 1-4 faqe; Kërkesa për përgjigje në ankesë me nr.prot.5161/2022 e datës 06.09.2022; Përgjigja në kërkesë për përgjigje në ankesë me nr.prot.5413/2022 e datës 15.09.2022 prej 1-9 faqe; E-mail nga Sh.T drejtuar I.G e datës 01.04.2022; E-mail nga I.G drejtuar Sh.T e datës 22.07.2022; Raporti i monitorimit për vitin 2020 në Komunën e Prizrenit me nr.prot.1732/2022 e datës 30.03.2022; Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për



vitin 2020; Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2021; Akt emërimi për N.K AE.Nr.01-112-157991/2021 e datës 07.10.2021; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit për N.K i datës 20.06.2016; Akt emërimi për D.H Nr.01-112-92579 i datës 26.06.2018; Akt emërimi për D.H, AE.Nr.01-112-157672/2021 e datës 07.10.2021; Akt emërimi për Xh.D nr.01-112-10581 e datës 18.01.2018; Lista e pagave për Xh.D për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; Akt emërim për A.K, A.E.Nr.01-112-157520/2021 e datës 07.10.2021; Shkresë "Katalogu I vendeve të punës nga Ministria; Akt emërim për A.K I datës 04.01.2012; Lista e pagave për A.K për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; Akt emërim për A.R , AE.Nr.01-112-157524/2021 e datës 07.10.2021; Lista e pagave për A.R për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; Akt emërim për N.M, AE.nr.01-112-158007/2021 e datës 07.10.2021; Vendim për transfer të përhershëm për N.M, nr.01-112-1458 e datës 04.01.2019; Lista e pagave për N.M për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; E-mail nga R.Z drejtuar O.H e datës 17.08.2018 me korrespondencën prej 1-3 faqe; Procedim në sistem të pagave nr.2464 e datës 01.08.2018; Shkresë "Tabela me pozitat e punës në Administratën e Komunës së Prizrenit" prej 1-3 faqe; Lista e nëpunësve civil të Komunës së Prizrenit prej 1- 5 faqe; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit për I.G e datës 20.06.2016; Akt emërim për I.G e datës 07.05.2014; E-mail nga I.G drejtuar Sh.T e datës 28.12.2021; Akt emërim për V.A e datës 04.01.2012; Lista e pagave për V.A për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; Akt emërim për F.K e datës 15.11.2013; Lista e pagave për F.K për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; Akt emërim për A.S e datës 13.11.2014; Lista e pagave për A.S për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; Akt emërim për H.G e datës 04.01.2012; Lista e pagave për H.G për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; Akt emërim për F.S, AE.Nr.01-112-157753/2021 e datës 07.10.2021; Akt emërim për F.S i datës 04.01.2012; Lista e pagave për F.S për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; Akt emërim për N.O e datës 04.01.2012; Lista e pagave për N.O për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022; Akt emërim për E.E, AE.Nr.01-112-157714/2021 e datës 07.10.2021; Akt emërim për E.E i datës 04.01.2012; Lista e pagave për E.E për periudhën kohore 01.08.2022 deri 31.08.2022, Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 11.10.2022 me numër Vk.nr.113/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, SEPSE:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 20.06.2016 i llojit të emërimit: I karrierës/pa afat është i punësuar në Komunën e Prizrenit, në pozitën: "Menaxher i Personelit", ndërsa Kryetari i Komunës së Prizrenit në cilësi të udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë i ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje me shkrim" me datë 27.07.2022, me arsyetimin se ankuesi nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme sipas kërkesës së kryetarit të datës 01.04.2022 lidhur me harmonizimin e koeficientëve sipas akt emërimeve duke u bazuar në të dhënat sipas të gjeturave të Raportit të Auditorit të vitit 2021 dhe 2022 për Komunën e Prizrenit.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar përmbajtjen dhe konstatimet e dhëna në vërejtjen me shkrim të datës 27.07.2022 të shqiptuar nga ana e Kryetarit të Komunës së Prizrenit dhe ka gjetur se

ankuesit masa disiplinore i është shqiptuar duke iu referuar dispozitave ligjore, respektivisht nenit 67 paragrafi 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj mbi këtë bazë Kolegji i këshillit ka konstatuar se masa e shqiptuar disiplinore e datës 27.07.2022 është e kundërligjshme ngase është lëshuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik pasi që me rastin e hyrjes në fuqi sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetues të datës 09.07.2020, neni 85 i këtij ligji ka përcaktuar se, citoj: *“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”*, nga rrjedh se për shkelje eventuale disiplinore, nëpunësve civil nuk mund tu shqiptohen masa disiplinore mbi bazën e dispozitave ligjore të ligjit i cili nuk është në fuqi, rrjedhimisht masa e shqiptuar disiplinore e datës 27.07.2022 është e kundërligjshme siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është në kundërshtim me ligjin material”*.

Po ashtu, akti i goditur përmes ankesës së ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmban të meta ligjore, respektivisht nuk përmban elementet e aktit administrativ siç përcaktohet në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase akti si i tillë është i paqartë, kundërthënës dhe arsyetimi i të njëjtit është i pamjaftueshëm ose i barabartë me mungesën e tij, ngase në rastin konkret, Kryetari i Komunës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore përmes shkresës së datës 27.07.2022 nuk ka arritur të arsyetoj mjaftueshëm se pse baza e përdorur ligjore është e zbatueshme në rastin konkret, sikurse këshilla e dhënë juridike nuk është e plotë, duke mos dhënë sqarime sipas obligimeve ligjore mbi mjetet ankimore, kohën dhe organin kompetent për trajtimin e ankesës së ankuesit, andaj mbi këtë bazë masa e shqiptuar disiplinore e datës 27.07.2022 është e kundërligjshme siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”* rrjedhimisht masa shqiptuar disiplinore-vërejtja me shkrim e datës 27.07.2022 është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, mbi bazën e të gjeturave si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, thekson faktin se për shkak të metave ligjore të aktit të ankimuar, të meta këto që e bëjnë të paligjshëm aktin në fjalë, e ka pasur të pamundur të bëjë shqyrtimin e ligjshmërisë në kuptim të verifikimit apo konstatimit nëse shkelja e supozuar është kryer apo jo, andaj mbi këtë bazë ankesa e ankuesit është aprovuar si në dispozitiv të këtij vendimi, për shkak të metave ligjore të aktit të ankimuar përmes ankesës së ankuesit të parashtruar në Këshill me datë 26.08.2022, ndërsa Kryetari i Komunës së Prizrenit, me rastin e shqiptimit të masave disiplinore në të ardhmen duhet të ketë parasysh vërejtjet e dhëna në këtë vendim.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.743/2022,datë 24/10/2022

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional




Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK-së